



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE**

**SHPALLJE VENDI VAKANT PËR POZICIONIN:
SPECIALIST I SEKTORIT KËRKIM DHE ZHVILLIM
DREJTORIA E INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE, PARTENRITETIT DHE
KËRKIMIT**

1. TË DHËNAT PËR POZICIONIN E PUNËS:

Emërtesa e pozicionit: Specialist i Sektorit të Kërkimit dhe Zhvillimit

Klasa e pagës: IV-1

Drejtoria: Drejtoria e Investimeve të Huaja Direkte, Partneritetit dhe Kërkimit

Raporton te: Përgjegjësi i Sektorit të Kërkimit dhe Zhvillimit dhe Drejtori i Drejtorisë së IHD, Partneritetit dhe Kërkimit

2. QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I POZICIONIT: Specialisti i Sektorit të Kërkimit dhe Zhvillimit përgjigjet te Përgjegjësi i Sektorit të Kërkimit dhe Zhvillimit dhe Drejtori i Drejtorisë së IHD, Partneritetit dhe Kërkimit dhe roli i tij/saj fokusohet në lehtësimin e investimeve të huaja të orientuara në mënyrë specifike drejt aktiviteteve kërkimit dhe zhvillimit.

3. DETYRAT KRYESORE:

- Hulumtim/Kërkim gjithëpërfshirës mbi tendencat globale teknologjite në zhvillim dhe mundësitë e investimeve për të identifikuar fushat e mundshme me interes për investitorët e huaj.
- Identifikimi dhe synimi i investitorëve të huaj të mundshëm, duke përfshirë korporatat shumëkombëshe, firmat e kapitalit sipërmarrës dhe institucionet kërkimore, me fokus tek ata që kërkojnë mundësi kërkimi dhe zhvillimi.
- Ofrimi i asistencës dhe mbështetjes së personalizuar për investitorët e huaj të interesuar në projektet, duke përfshirë lehtësimin e prezantimeve në institucionet lokale.
- Kryerja e kujdesit të duhur për investitorët e huaj potencialë për të vlerësuar besueshmërinë, kapacitetin financiar dhe historikun e tyre në investimet në kërkim dhe zhvillim, duke siguruar përafrimin me qëllimet e zhvillimit ekonomik të vendit pritës.
- Analizimi i politikave, rregulloreve dhe stimuljeve në lidhje me investimet në kërkim dhe zhvillim për të identifikuar mundësitë për përmirësim ose përmirësim për të krijuar një mjedis investimi më të favorshëm.
- Ndjekja e flukseve hyrëse të investimeve, monitorimi i progresit dhe ndikimit të projekteve, vlerësimi i efektivitetit të strategjive të nxitjes së investimeve për të informuar vendimmarrjen dhe rregullimet strategjike.

- Bashkëpunimi me agjencitë qeveritare, shoqatat e industrisë, institucionet akademike dhe palët e tjera të interesuara për të koordinuar përpjekjet në promovimin e investimeve dhe nxitjen e një ekosistemi mbështetës.
- Zhvillimi i materialeve të marketingut, prezantimeve dhe propozimeve për të shfaqur mundësitë e investimeve, nxjerrjen në pah të pikave të forta të vendit.

4. KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDITATI

Kushtet e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati janë:

- a - Të jetë shtetas shqiptar;
- b - Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c - Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d - Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e - Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f.- Ndaj tij të mos jetë marrë asnjë masë disiplinore gjatë 6 muajve të fundit të periudhës kohore të punës.

5. KËRKESAT E POSAÇME:

Arsimi: Bachelor në administrim biznesi, shkenca politike, komunikimi, ekonomike, kompjuterike, inxhinierike, si dhe diploma ose çertifikata të avancuara në lidhje me fushën e përgjegjësisë. Diplomati, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.

Përvoja: Të ketë paktën 2 (dy) vite eksperiencë pune në sektor që lidhen me misionin e drejtorisë.

Tjetër: Të ketë njohuri në fushën e metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike dhe/ose analitike. Të ketë aftësi për të integruar informacionin me politikat institucionale. Të ketë aftësi për të identifikuar dhe qartësuar çështje, si dhe për të dhënë mendime alternative të mbështetura në përvojën profesionale. Të ketë aftësi për të vlerësuar opsione politikash dhe për të parashikuar pasojat nga përzgjedhja e tyre. Të ketë njohuri të gjuhës angleze; njohja edhe e gjuhëve të tjera përbën avantazh.

6. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a - Jetëshkrim i plotësuar në gjuhën shqipe në përputhje me standardet e legjislacionit shqiptar;
- b - Fotokopje të diplomës. Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;

- c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhet në zyrën e protokollit të institucionit me adresë: **Rruga “Skerdilajd Llagami”, Nd.1, H.6, Tiranë** ose në adresën zyrtare të e-mailit: **info@aida.gov.al**.

Kandidatët e interesuar paraqesin kërkesën për aplikim, dokumentacionin si më sipër dhe dokumentacionin vërtetues për kriteret e përgjithshme dhe të posaçme brenda datës: **(04.02 .2025 afati i fundit i aplikimit)**.

7. REZULTATET PËR FAZËN E KONKURRIMIT

Në vijim, AIDA do të realizojë:

1- Fazën e parë të konkurrimit e cila konsiston në verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore;

a- nëse dokumentacioni i paraqitur nga çdo kandidat vërteton plotësimin e kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta në shpalljen për konkurrim.

b- nëse kandidatët plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të vendit të punës;

2 - Faza e dytë e konkurrimit është faza e intervistimit të punonjësve të kualifikuar nga komisioni. Në këtë fazë komisioni bën një vlerësim të formimit të përgjithshëm të kandidatëve si dhe vizionit të tyre personal në lidhje me veprimtarinë e AIDA-s.

8. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Në përfundim të fazës së dytë komisioni i përzgjedhjes bën një vlerësim me pikë. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 pikë.

Për vlerësimin e kandidatëve, secili anëtar jep pikët e tij. Në përfundim pikët e grumbulluara mbledhen. Shuma e pikëve të mbledhura nga të gjithë anëtarët pjesëtohet me numrin e anëtarëve të tij dhe kjo vlerë përbën rezultatin përfundimtar.

Komisioni i Përzgjedhjes jep vlerësimin e tij sipas rregullores mbi kandidatët potencialë për

punësim duke e shoqëruar me një raport përmbledhës.

Raporti përmbledhës së bashku me listën e 3(tre) kandidatëve që kanë arritur rezultate më të larta i paraqitet Drejtorit Ekzekutiv brenda një afati 5 (pesë) ditor nga përfundimi i vlerësimit.